

TRAJTIMI I ISLAMIT NË MEDIAN SHQIPTARE

Në ditët që jetojmë impakti i medias është tepër i madh, veçanërisht i asaj elektronike, ku njerëzit preferojnë që gjithçka ta marrin “të gatshme” dhe rrallë e përpunojnë apo e shohim me dyshim atë që u ofrohet. Në këtë pikëpamje, media që duhet të mbartë funksion informues dhe edukues, shpesh merr më tepër trajtat e çedukimit dhe të keqorientimit.

Përgjatë një shekulli, në median shqiptare, çështja islame është trajtuar nga këndvështrime të ndryshme, të cilat herë-herë vërtiten edhe në kahe diametralisht të kundërta. Me anë të këtij materiali, do të rrekemi të paraqesim prirjet dhe specifikat kryesore të shpërfaqjes së islamit përmes të të ashtuquajturit pushteti i katërt, pra përmes pushtetit të medias.

Çështje të ndryshme që lidhen me islamin, në disa media shqiptare janë paraqitur të përçudnuara, sepse pas këtij terri dhe kaosi informativ fshihen qëllime keqdashëse ndaj popullsisë shqiptare, e cila dominohet nga myslimanët. Sipas statistikave zyrtare, mbi 70% e popullsisë i përket besimit mysliman. Shumica e këtyre besimtarëve nuk janë praktikantë të islamit, por thjesht ndjekin traditën familjare të besimit, duke zbatuar pjesërisht disa prej riteve islame, si p.sh.: agjërimin e muajit të Ramazanit, moskonsumimin e alkoolit dhe të mishit të derrit etj. Megjithatë, mospraktimi i rregullt i riteve fetare islame e bën këtë kategori besimtarësh një kontingjent të luhatshëm dhe të hapur për të përqaftuar besime të tjera.

Propaganda mediatike është një nga format që përdoret për të përthithur prej radhëve të myslimanëve, ose për të tulatur përkatësinë e tyre fetare. Kjo propagandë është e orientuar në dy skajet ekstreme: pro dhe kundra islamit, ndërsa rastet e pasqyrimeve objektive janë të rralla. Këto dy lloje pasqyrimesh kanë krijuar edhe stereotipin antagonist, ku nga njëra anë islami shihet si fe paqësore dhe nga ana tjetër si fe fanatike, madje identifikohet edhe me organizatat terroriste. Prandaj,

për të kuptuar realitetin mediatik shqiptar dhe këtë skajshmëri qëndrimesh është e udhës të marrim në konsideratë disa të dhëna për sfondin historik të rrugës së zhvillimit të kësaj fushe, si dhe kalvarin e vuajtjeve e persekutimeve që ndeshën myslimanët shqiptarë përgjatë viteve.

Duke tentuar të bëjmë një periodizim të medias shqiptare, duke marrë për bazë kriterin e tematikës islame dhe mënyrën e qasjes ndaj kësaj lënde, na rezultojnë tri periudha të pasqyrit të besimit dhe çështjeve islame në media:

***Periudha e parë (Gjysma e parë e shek. XX: 1910-1945):
Përndritja shpirtërore e kombit dhe lulëzimi i shtypit islam.***

Shtypi periodik islam shqiptar filloi rregullisht në shekullin XX. Ai zë fill me pavarësinë e Shqipërisë, me krijimin e shtetit të parë shqiptar dhe merr fizionominë e plotë me formimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, si institucion vetadministrues me formulimin e statusit të tij. (Zekaj 1996: f.202). Pra, gazetat dhe revistat, gjatë kësaj kohe, kanë qenë mjete propagandues i besimit islam. Aspekte të çështjeve të besimit ndër shqiptarë janë prekur që në gazetën e parë shqiptare "L'Albanese d'Italia" ("Shqiptari i Italisë"), në vitin 1848. Në mënyrë të mirëfilltë, çështjet fetare janë trajtuar në periodikët me frymë islame, që zanafillën e kanë në vitin 1910 me gazetën «Dielli», për të vijuar më tej me periodikët: "HANA", SEDA I MILET" ("Zëri i Kombit" 1913-1914), "REFORMA" ("Bektashi"), "UDHA E S'VËRTETES" (Shkodër, 1923), "ZANI I NALTË" (Organ periodik i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë 1923-1938), "TAKVIM" (Shkodër, 1937-1938), "NJERIU" (1942-1944) etj. (Boriçi, Hamit: "Historia e shtypit islam shqiptar"; dorëshkrim: f.19).

Kjo shumësi titujsh solli larmishmëri këndvështrimesh teologjike, që e shihnin besimin islam në rrafsh shumëdimensional, por njëherësh u zgjerua edhe më tej me problemet e filozofisë, të moralit, të letërsisë kombëtare dhe të sociologjisë, duke iu drejtuar një rrethi të gjerë lexuesish.

Niveli i shkrimeve publicistike dhe i përkthimeve ishte shumë i lartë, sepse në këto gazeta shkruanin intelektualët më të rëndësishëm të kohës, me përgatitje të madhe në fushën e kulturës dhe të shkencave islame, e më gjerë, si: Ismail Maçi, Isa Domni,

Haki Sharofi, Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Korça, Sali Vuçiterni, Mehdi Frashëri, Mithat Frashëri (Lumo Skëndo), Ismet Dibra, Ferid Vokopola etj.

Personalitete të tilla, jo vetëm përndritën mendjet e besimtarëve myslimanë, por patën një rol të rëndësishëm edhe për konsolidimin e shtetit shqiptar. Ata u sinkronizuan plotësisht me jetën dhe veprimtarinë kombëtare, me interesat dhe me problemet e mëdha të atdheut. (Roberto Morrozo Della Rocca: f. 79). Patriotizmi e kontributi i klerit mysliman është pranuar gjerësisht nga historianët dhe studiuesit shqiptarë. Çështja fetare është trajtuar gjithnjë e pandarë nga çështja kombëtare. Pra, feja dhe kombi ishin një dhe Shqipëria konsiderohej një komb mysliman.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, veçanërisht në vitet '20, u bënë përpjekje me rëndësi për organizimin e myslimanizmit shqiptar mbi baza kombëtare. Këto përpjekje u favorizuan nga ndryshimet e mëdha politike dhe nga vetë shteti shqiptar, i cili ndihmoi shumë për kombëtarizimin dhe ristrukturimin e komuniteteve të ndryshme fetare. (Basha, Ali 2000: f.116). Numri i bashkëpunëtorëve, gazetarëve dhe publicistëve që shkruanin mbi çështje të islamit rritej dita-ditës.

Pavarësisht lulëzimit të shtypit islam qysh në ngjizjen e tij, pati zëra kundër islamit. Kështu, gjatë kësaj periudhe janë botuar një seri shkrimesh publicistike nga Tajar Zavalani, Ismet Tota, etj., të cilët e konsideronin mbulesën në islam si simbol të prapambetjes dhe bënin thirrje që shqiptarët të orientoheshin drejt oksidentit dhe jo orientit, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund të bëheshin qytetarë të denjë të Evropës.

Shkrimet kundër islamit nuk ishin problemi i vetëm gjatë kësaj kohe, sepse vetë pjesa dërrmuese e popullsisë shqiptare ishte e paarsimuar, nuk dinin shkrim e këndim dhe për pasojë, periodikët islamë, ashtu si dhe çdo material tjetër, shpërndaheshin në një rreth të ngushtë lexuesish. Prandaj, vlen të theksojmë se dukuria mbizotëruese e kësaj periudhe lidhet me faktin se nga njëra anë shtypi islam konsolidohej dita-ditës dhe niveli i profesionalizmit ishte në rritje të pandalshme, e nga ana tjetër, rrjeti i lexuesve ishte i kufizuar, për shkak se dominonte analfabetizmi.

Periudha e dytë (1954-1991). Terri informativ dhe censura e tejskajshme.

Periudha e regjimit komunist në Shqipëri për më shumë se katër dekada izoloi çdo hallkë të veprimtarive fetare, ndaloi me ligj ushtrimin e besimit, persekutoi e pushkatoi qindra klerikë dhe shkatërroi të gjitha objektet e kultit. Shumica e xhamive u shembën tërësisht, ose u përçudnuan duke u kthyer në magazina mallrash dhe në pijetore, ku konsumohej alkooli (p.sh. xhamia në qendër të Durrësit ka shërbyer si bar-bufe, ku haheshin e piheshin produkte që islami i konsideron si haram). Me shkatërrimin e xhamive, teqeve, tyrbeve etj., humbën shumë dokumente, dorëshkrime e vepra të tjera me rëndësi të madhe historike, nën etiketën se ishin fetare dhe ishin shkruar me alfabetin arab. Këto akte u kurorëzuan me hapjen e muzeut ateist. Anarkizmi dhe injoranca e këtyre veprimeve vinte nga mendësia komuniste se çdo gjë fetare duhej zhdukur, për t'u zëvendësuar me ideologjinë komuniste.

Në këtë situatë të asfiksimit shpirtëror e moral, as që mund të imagjinohej qarkullimi i shtypit islam, madje edhe nëse përdorej ndonjë element i terminologjisë fetare në kontekstin e përgjithshëm socio-kulturor, gazetarët burgoseshin e përndiqeshin gjatë gjithë jetës.

Më 6 shkurt të vitit 1967, komunizmi e fitoi plotësisht betejën me fenë, sepse mbylli organet e shtypit, shkollat e përgatitjes së klerikëve, mbajtjen e ligjëratave fetare dhe madje nuk lejoheshin as shprehjet me ngjyresë fetare apo përmendja e emrit të Zotit. Dhuna fizike e materiale ndaj klerikëve dhe objekteve të kultit, përhap i indirekt mesazhet e dhunës shpirtërore në gjithë popullsinë shqiptare. (Ali Basha: f. 267)

Feja konsiderohej si opium për popullin, edhe pse në fakt ajo ishte ilaçi që e shëronte atë shpirtërisht dhe moralisht. Sipas komunistëve, Zoti nuk ekzistonte dhe partia ishte zot i jetës së njeriut. Kështu, edukata komuniste krijoi ndër shqiptarët një psikologji antinjerezore dhe antikombëtare me ndjeshmëri të ulët ndaj problemeve kombëtare dhe atyre fetare. Zoti u përjashtua nga jeta zyrtare dhe ajo familjare dhe në këtë mënyrë u krijua atmosfera e egër, e tejskajshme materialiste e jetës sociale. (Bardhyl Fico, Bedri Bylyku 1994: f.13).

Komunizmi i shtriu tentakulat e veta në çdo qelizë të shoqërisë dhe arriti që ta kultivojë njeriun e ri (kështu quhej komunisti) me frymën ateiste dhe antifetare.

Zënia vend e propagandës ateiste në një pjesë të popullatës lidhet edhe me faktin se, në përgjithësi, popullsia shqiptare njohuritë fetare i kishte të përcipta dhe kryesisht predominonte besimi fetar mbi bazën e trashëgimisë familjare, ku zbatimi i riteve fetare ishte i reduktuar dhe përgjithësisht njerëzit nuk e dinin domethënien teorike të tyre. (Shefik Osmani 1994: f. 55).

Shtypi periodik me përmbajtje fetare pati mundësi zhvillimi vetëm në diasporë dhe në Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë, ku jetonin rreth tre milionë shqiptarë, në shumicën dërrmuese myslimanë dhe me tradita fetare islamike, të cilët, duke shfrytëzuar disa hapësira kushtetuese, arritën të bëjnë një sërë botimesh, që e mbajtën gjallë bashkësinë islame. Ndërsa në Shqipërinë shtetërore dominoi terri informativ, si në çështjen e pasqyrimeve mediatike, ashtu edhe në mundësitë inekzistente të mbujtjes me edukatë fetare, sepse u mbyll çdo institucion arsimor fetar. E gjithë kjo panoramë dëshmon qartazi edhe nivelin e shtypit islam në fazën komuniste, por edhe gjendjen dhe botëkuptimin e shqiptarëve ndaj fesë në tërësi.

Periudha e tretë (1991-2013): Keqpërdorimi i lirisë së shprehjes

Rënia e komunizmit e gjeti Shqipërinë thuasje tërësisht ateiste, ku besimi në Zot ishte zvetënuar edhe tek ata njerëz që dikur e kishin të konsoliduar besimin dhe ritet fetare. Njerëzit e kishin humbur ngjyresën shpirtërore për shkak të propagandës së egër dhe torturave çnjerëzore të komunizmit.

Çështja themelore, me të cilën duhej të përballlej demokracia shqiptare ishte shëndoshja shpirtërore e njerëzve. Vlerat njerëzore e shoqërore ishin çoroditur si pasojë e rrënimit dhe dehumanizimit të mbjellë prej gati gjysmë shekulli. Vetëm një popull i shëndoshë shpirtërisht do të mund të përballonte sakrificat, të varroste të shkuarën e errët, të ndërtonte shpresat, për të projektuar të ardhmen. Në vend që media postkomuniste të ndiqte këtë rrugë të rëndësishme dhe t'i ushqente shpirtrat e bashkëkombasve me mesazhe paqeje e harmonie, në shumë raste ajo u bë vegël e interesave të caktuara.

Shqipëria, u bë vendi ku hynin sekte e besime fetare të ndryshme. Edhe pse në periudhën parakomuniste, 80% e popullsisë ishin myslimanë, ndërsa pjesa tjetër i përkisnin besimit katolik dhe ortodoks, pas viteve '90 "u sulën" lloj-lloj sektesh të dyshimta, të cilat vijojnë të shfrytëzojnë varfërinë dhe naivitetin e shqiptarëve dhe rekrutojnë në radhët e tyre shpesh edhe myslimanë me tradita familjare. Denoncimet mediatike për sekte të tilla, për kishat që hapen vend e pa vend, për kryqet që vihen në mes të rrugëve nacionale, janë të pakta, ndërsa gjithçka që lidhet me islamit shihet me dyshim.

Qysh në fillimet e demokracisë, shtypi opozitar i kohës (gazetat "Zëri i popullit", "Koha jonë", "Alternativa social-demokrate" etj.) u hodh në një sulm të paprinciptë ndaj islamit, duke përhapur akuza se në Shqipëri po hyjnë fundamentalistët dhe ferexhetë, denoncohej organizimi i konferencave me frymë islame dhe baltosej e mbillej gjuha e urrejtjes ndaj çështjeve islame, kryesisht duke luajtur me kartën e barasvlerësimit të islamit me antievropianizimin. Gjithashtu, gjatë periudhës 1991-1993, qarkulluan edhe disa fletushka, në përmbajtjen e të cilave kishte artikuj propagandistikë me karakter gazetaresk, që në disa raste nxitnin polemika pa vend. Kështu, për shembull, konsiderohej kthim prapa në kohë çështja e mbulimit të femrës dhe shumë parime morale islame shiheshin si elemente prapanike.

Ndërsa pas sulmeve të 11 shtatorit 2011 në SHBA, etiketimi "terrorist" gjeti shtrirje të gjerë në median shqiptare dhe ashtu sikundër ndodhi edhe në shumë vende të tjera, çdo mysliman shihej si person potencial për t'u inkriminuar në rrjete terroriste. Propaganda e padrejtë dhe qëllimkeqe mediatike e identifikimit të islamit me grupet terroriste e ka rrënuar imazhin e këtij besimi. Kohët e fundit është fashitur kjo lloj propagande, por grimca të saj vijojnë ende të gjallojnë në disa televizione, që përzgjedhin për transmetim lajme që e rëndojnë imazhin e islamit. Sidomos pas të ashtuquajturës "pranverë arabe", raportimet mediatike fokusohen te dhuna, lufta, prapambetja dhe anarkia e pushteteve në botën arabe dhe rrallë bëhen përcjellës të zhvillimeve pozitive, të veprave të bamirësisë, të jetës kulturore e shkencore që ekziston në këto vende. Për pasojë, perceptimi që krijohet te publiku është se në vendet arabe nuk prodhohet asgjë, përveçse zhvillohen

akte dhune dhe diskriminohen shtresa të caktuara shoqërore, veçanërisht gratë.

Mungesa e transparencës dhe paraqitjes me vërtetësi të realitetit, apo përzgjedhja e lajmeve të këqija dhe jo atyre që dëshmojnë suksese e zhvillim, duket si një politikë e qëllimshme mediatike, e cila ka gjalluar edhe në Shqipëri, kuptohet edhe nën ndikimin e shumë agjencive ndërkombëtare të lajmeve.

Kjo është ana e errët e medaljes, por nga ana tjetër nuk duhet të lëmë pa theksuar se periudha paskomuniste shenjoi një kapitull të ndritur për besimet fetare dhe islamin në veçanti.

Rihapja e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë mundësoi riorganizimin e bashkësisë islame në vend dhe që prej vitit 1992 filloi botimin e organit 2-javor "Drita islame", nën maksimën "Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr", revistë që vijon edhe në ditët e sotme. Këtë revistë e pasuan edhe dhjetëra gazeta e revista të tjera mirëfilli islame, por edhe shtypi i përditshëm laik filloi të pasqyrojë pa paragjykime veprimtaritë kulturoro-fetare në vend dhe mendimet e teologëve të ndryshëm shqiptarë në lidhje me çështje sociale.

Në përmbajtje të organeve periodike me frymë islame janë çështje që lidhen me moralin e kësaj feje, histori profetike, por edhe probleme e aspekte të aktualitetit dhe shoqërisë shqiptare. Qëllimi i tyre mbetet konsolidimi i besimit islam dhe përhapja sa më e gjerë e njohurive bazë rreth kësaj feje.

Sipas studiuesit Ramiz Zekaj, shtypi periodik islamik shqiptar i ditëve të sotme, duke iu përmbajtur frymës së humanizmit, trashëgon traditat më të mira të lëna nga paraardhësit e tij, siç ishin revistat "Zani i Naltë" dhe "Kultura Islame". Ai synon ta farkëtojë bashkimin kombëtar në frymën e mësimëve të Kuranit, duke mos lejuar që institucionet e huaja fetare joislamike të luftojnë për eliminimin e islamizmit në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, duke iu përmbajtur mendimit të shëndoshë, synon të luftojë kundër rrymave ekstremiste, që në emër të Islamit, kërkojnë t'i fryjnë zjarrit për ndasi fetare e kombëtare. (Zekaj 1996: f.233)

E metë e shtypit islam shqiptar është mungesa e kundërpërgjigjeve ndaj sulmeve që bëhen nga gazeta apo media të caktuara për çështje të ndryshme. Është e udhës që media islame në përgjithësi të jetë më solidare dhe bashkëpunuese për

të krijuar në bllok një frymë reagimi ndaj padrejtësive që i bëhen imazhit të myslimanit.

Përveç solidaritetit ndërmediatik, në panoramën mediatike shqiptare ka nevojë për më shumë hapësira radiofonike e televizive që të përcjellin fjalën e Zotit. Edhe pse mbi 70% e popullsisë shqiptare janë myslimanë, sërish numri më i madh i hapësirave mediatike shqiptare u përket besimeve katolike e ortodokse. Aktualisht, në Shqipëri gjenden tri radio për besimet e krishtera (dy për besimtarët katolikë dhe një për ata ortodoksë) dhe vetëm një radio islame. Ndërsa nuk ka asnjë televizion të profilizuar mirëfilli në transmetime programacioni fetar të vazhdueshëm. Sigurisht që dhënia e më shumë hapësirave të medias elektronike për transmetimin e fesë islame do të ndikonte në informimin më të gjerë dhe në ndërgjegjësimin e popullsisë shqiptare për islamin e vërtetë dhe për përfitimet e mëdha që i vijnë njeriut nga besimi në Zot.

Burimet:

- Bardhyl Fico, Bedri Bylyku (1994), in the book: "The role of islam in postcommunist Albanian society", (internacional semirar) Toena, Tiranë, 1994 (9-12 dhjetor 1994).
- Basha, Ali (2000) "Islami në Shqipëri gjatë shekujve", Tiranë.
- Basha, Ali, Revista "Univers", nr. 3, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), Tiranë, 2002.
- Boriçi, Hamit: "The history of the Albanian Islamic", (Press; manuscript).
- Kutub, Sejjid (1979) "In the Shade of the Qur'an", ("Nën hijen e Kur'anit"), London.
- Osmani, Shefik, (1994), in the book: "The role of islam in postcommunist Albanian society", (internacional semirar) Toena, Tiranë, 1994 (9-12 dhjetor 1994).
- Roberto Morrozo Della Rocca (1997) Albania: "Le radici della crisi" (Italian Edition), Guerini, Italy.
- Zekaj, Ramiz (1996) "Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX" Tiranë, AIITC.